



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 14.02.2024

NR.09/1369/2024

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-24-235-2-3-6/C494 & KKHE-24-002-2-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Vllaznim Jakupi B.I., Koshare pn., Feriaj, 811067588, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Transmetimi i drejteperdrejte i seancave të Kuvendit të Komunes Hani i Elezit për vitin 2024 me numër identifikues: 659-24-235-2-3-6

Neni 1 Lënda

6.2 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Transmetimi i drejteperdrejte i seancave

No.	Lot
1	Transmetimi i drejteperdrejte i seancave të Kuvendit të Komunes Hani i Elezit për vitin 2024

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 4,950.00 €; [Kater mijë e nëntqind e pesdhjetë Euro/zero zero centi / Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	14/02/2024
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Vllaznim JAKUPI
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	14.02.2024
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri I kontratës: 659-24-235-2-3-6/C494

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi I Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi I nenit	Nr. Nenit	
Ligji I zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi I shërbimeve.	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është [14.02.2024]
	6.4	Data e Përfundimit është [13.02.2025].
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është [Kuvendi komunal i Komunes Hani i Elezit dhe ambientet e tjera të Komunes për transmetime].
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është do të cakohet me vendim të veçantë të ZKA-se
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë për shërbime të parealizuar. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës me afat prej 13 mujave
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: [Pagesa do të bëhet pas realizimit të shërbimit të transmetimit i pranuar nga AK- dhe menaxheri i kontratës].
		Transmetim i drejtpërdrejtë do të llogaritet vetëm për punimet e kuvendit kurse inqizimet mund të transmetohen në një kohë me të pershtatshme në koordinim me AK-ne.
		Kurse vlen për tu theksuar se pauzat nuk hyjnë apo nuk do të llogariten si minutazh të transmetimit.
		Kohë trametimi llogaritet koha e fillimit deri në pauza, ashtu siç caktohet koha nga Kryesuesi i Kuvendit. Pra, përjashtohen përgatitjet (montimi i teknikes dhe elementeve percjellese).
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: [shëno]
		Periudha Garantuese e Defekteve është [shëno datën]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose përmes procedurave alternative të zgjidhjeve se mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetësimit me pajtimin e të dy palve

		ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].
--	--	--